



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Nr. 411 Prot.

Tiranë, më 13/5/2015

REKOMANDIM

Nr. 30, datë 13/5 /2015

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në kuadër të inspektimeve të ushtruara në disa Shoqëri të Kursim-Kreditit dhe Unioneve të tyre, që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e këtij sektori, në ngarkim të kontrolluesit “**Banka e Shqipërisë**”,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka realizuar hetim administrativ, mbi bazë ankese dhe kryesisht, pranë disa kontrolluesve “Shoqëri të Kursim-Kreditit dhe Unioneve të tyre”, konkretisht (rastet për të cilat është dalë me akt përfundimtar):

- Shoqëria e Kursim Kreditit “Vlora Kredit”, Vlorë;
- Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona”, Tiranë;
- Unioni Shqiptar Kursim Kredi (USHKK), Tiranë;

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e këtij sektori në kuadër të impaktit që ka mbi qytetarët kredimarrës, anëtarë të Unioneve, dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave të tyre personale dhe privatësisë së tyre, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm, procesin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit në këtë sektor. Në këtë kuadër, janë evidentuar disa nga problematikat e hasura më shpesh në këtë fushë, referuar praktikës së deritanishme në zbatim të ushtrimit të funksionit monitorues dhe mbikëqyrës së Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit, dhe mangësive të konstatuara gjatë kontrolleve administrative të ushtruara në secilin kontrollues që operon në këtë fushë.

Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre kryesisht, në zbatim të ligjit nr. 8782, datë 03/05/2001 “Për shoqëritë e kursim kreditit”, aktet nënligjore në këtë fushë, dhe Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për mbikëqyrjen e Shoqërive të Kursim Kreditit dhe Unioneve të tyre” (Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 08.06.2005, i ndryshuar). Në kuptim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre konsiderohen kontrollues dhe janë përgjegjëse për zbatimin e të gjitha detyrimeve që përcakton ky ligj në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave klientë (kredimarrës, anëtarë të Unionit) dhe punonjës.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimeve administrative në kontrolluesit e cituar më sipër, ka konstatuar se:

- Kontrolluesit kanë kryer përpunim të paligjshëm të të dhënave personale të subjektit të të dhënave (kredimarrës), pa marrë pëlqimin paraprak të tij, në shkelje të nenit 5, pika 1/a/ç dhe nenit 6, pika 1/a të Ligjit nr. 9887, dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
- Aksesit në Regjistrin e Kredive nga ana e “përdoruesve të autorizuar” (punonjës të Shoqërisë së Kursim Kreditit), kryej pa verifikuar paraprakisht pëlqimin e klientit/kredimarrësit duke krijuar hapësirë për shkelje të dispozitave ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale, konkretisht nenin 5 (pika 1, shkronja a dhe ç) dhe nenin 6, pika 1/a të ligjit, Kreu II “Përpunimi i të dhënave personale”, në të cilin parashikohen parimet e përpunimit të të dhënave personale);
- Kontrolluesit nuk kanë hartuar Rregullore të Brendshme për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale”, sipas formatit tip të publikuar në faqen e Zyrës së Komisionerit, www.idp.al, por kanë rregulla sektoriale sipas departamenteve përkatëse.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të dokumentacionit, provave dhe legjislacionit përkatës, Zyra e Komisionerit ka dalë me Vendim gjobe për kontrolluesit Shoqëria e Kursim Kreditit “Vlora Kredit” dhe Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona” dhe me Rekomandim për “Unionin Shqiptar Kursim Kredi” (USHKK). (Këto akte do t’i gjeni bashkëlidhur).

Banka e Shqipërisë është autoriteti që licencon dhe mbikëqyr procesin e krijimit dhe veprimtarisë së Shoqërive Kursim-Kreditit (SHKK) dhe Unioneve që krijohen nga bashkimi i këtyre shoqërive në përputhje me Ligjin nr. 8782, datë 03/05/2001 “Për shoqëritë e kursim kreditit” dhe Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për mbikëqyrjen e Shoqërive të Kursim Kreditit dhe Unioneve të tyre” (Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 08.06.2005 , i ndryshuar).

Sa më sipër;

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar neni 29, 30, 31/a/1 dhe në kuadër të problematikave të hasura dhe konstatimeve të realizuara gjatë hetimeve administrative në kontrolluesit që ushtrojnë veprimtari në këtë sektor,

REKOMANDOJ:

1. Të tregohet kujdes në monitorimin e Shoqërive Kursim-Kreditit (SHKK) dhe Unioneve që krijohen nga bashkimi i tyre lidhur me procedurat për marrjen e pëlqimit paraprak dhe të shprehur të kredimarrësve (në cilësinë e subjektit të të dhënave), në zbatim të nenit 5 pika 1/a/ç dhe nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

2. Të tregohet kujdes në monitorimin e procesit të aksesit të “përdoruesve të autorizuar” në Regjistrin e Kredive në mënyrë që të verifikohet paraprakisht pëlqimi i klientit/kredimarrësit, në zbatim të nenit 5 pika 1/a/ç dhe nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;
3. Të nxiten dhe ndërgjegjësohen kontrolluesit që operojnë në këtë fushë, mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ofrimit dhe garantimit të standardeve të sigurisë, nëpërmjet hartimit të Rregullores së Brendshme për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale”, (mund të përdoret formati tip i publikuar në faqen e Zyrës së Komisionerit, www.idp.al)
4. Sa i përket masave të ndërmarra në vijimësi në lidhje me zbatimin e këtij Rekomandimi, në kuadër të bashkëpunimit institucional, të vihet në dijeni Zyra e Komisionerit.

BESNIK DERVISHI

